



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1596/1 Prot.

Tiranë, më 13 / 11 / 2018

V E N D I M

Nr. 227, Datë 13 / 11 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 81, datë 07.06.2018, të paraqitur nga E.M kundër Spitalit Rajonal Gjirokastrë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se, prej vitit 2015 ka qenë i punësuar në pozicionin si shofer pranë Spitalit Rajonal Gjirokastrë. Gjatë gjithë periudhës së marrëdhënies të punës ka kryer detyrën me korrektësi dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje apo aksident automobilistik. Ankuesi informon se, me shkresën nr.111, datë 02.02.2018 të Drejtorisë së Spitalit Rajonal Gjirokastrë, është larguar nga puna dhe arsyeja e largimit të tij është bërë për shkak të mungesës së karburantit, pa përcaktuar sasinë. Për këtë motivacion ka bërë ankim pranë Ministrisë së Shëndetësisë² për të kërkuar sqarime dhe pas kësaj e kanë larguar nga puna me motivacionin për mosplotësim të dosjes personale në kohën e duhur si dhe ka patur mungesë karburanti pas llogaritjeve mujore nga Zyra e Planit. Ankuesi shpjegon se, në zgjedhjet e vitit 2013 ka mbështetur deputetin e subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, prandaj po luftohet politikisht.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

¹ Karta e anëtarësisë nr.6430, datë 29.04.2016, E.M anëtar i subjektit politik: “Lëvizja Socialiste për Integrim”.

² Në shkresën nr.405/1, datë 20.04.2018 të Spitalit Rajonal Gjirokastrë drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në mes të tjerash sqarohet si më poshtë: “...ish-punonjësi nuk i dorëzoi dokumentat e kërkuara në afatin e përcaktuar në njoftim dhe as më vonë, pranë zyrës së Burimeve Njerëzore. Detyrimi i bindjes ndaj Urdhrit të titullarit nuk u përmbush. Gjithashtu gjatë një kontrolli të bërë nga Zv/Drejtori Ekonomik dhe Përgjegjësi i Sektorit të Planifikim Prokurimeve, është konstatuar se punonjësi rezultonte në mungesa në karburant”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- A. Me shkresën nr. 822/1, datë 14.06.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektivit, Spitali Rajonal Gjirokastrë, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga E.M si dhe kopje të dokumenteve të mëposhtëm:
- Kopje të procedurës së emërimit (kopje të kontratës së punës) dhe lirimit të punonjësit E.M.
 - Kopje të procedurës së emërimit (kopje të kontratës së punës) të shoferit të ri të punësuar.
 - Kopje të Urdhrit nr. 501, datë 26.12.2017 “Për verifikimin e dosjeve të personelit jomjeksor të administratës së Spitalit Rajonal Gjirokastrë për përpushmërinë e vendit të punës me arsimin përkatës”.
 - Kopje të raportit përfundimtar në zbatim të Urdhrit nr. 501, datë 26.12.2017 dhe masat e marra sipas gjetjeve të raportit.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Kopje të shkresës nr.29, datë 08.01.2018 “Njoftim për plotësim të dosjes personale” dhe përgjigjes së dhënë nga punonjësi E.M.
- Emrat e punonjësve të tjerë të cilët kishin mangësi në dosje dhe për të cilët është marrë masë disiplinore.
- Kopje të vlerësimit të punës për vitet 2015, 2016 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2017 për E.M.
- Kopje të procedurës së verifikimit së mungesës së karburantit nga Zyra e Planit për punonjës të E.M.
- Kopje të verifikimit të konsumit të karburantit në Sektorin Teknik për të gjithë shoferët gjatë periudhës së vitit 2016 dhe 6-mujorit të parë të vitit 2017.

Me shkresën Nr. 783/1, datë 28.06.2018 të administruar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nr.822/2, datë 05.07.2018, Spitali Rajonal Gjirokastrë, informoi se: *“Punonjësi E.M nuk është diskriminuar në asnjë moment për motive politike por në qoftë se pranon se në ambientet e institucionit ka ushtruar aktivitet politik, atëherë kjo bie ndesh me VKM nr.42, datë 25.01.2017 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin Evropian” dhe VKM nr.319, datë 15.04.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për reformën në administratën publike” në të cilën depolitizimi përmendet si një nga objektivat e qeverisë dhe si një kriter i rëndësishëm për anëtarësimin e vendit në BE ku administrata duhet të përballet me sfida të mëdha në realizimin e detyrimeve që lidhen me qëndrueshmërinë dhe depolitizimin për të pasur një administratë efektive. Spitali Rajonal Gjirokastrë është institucion që ofron shërbim të kujdesit shëndetësor dhe nuk ka asnjë lloj informacioni për bindjet politike të punonjësve”.*

Spitali Rajonal Gjirokastrë, bashkëngjitur shkresës vuri në dispozicion të Komisionerit, dokumentet si më poshtë:

- Kopje të procedurës së emërimit dhe largimit nga puna të E.M.
- Kopje të shkresës nr.29, datë 08.01.2018 “Njoftim për plotësim të dosjes personale”.
- Kopje të kontratës individuale të punës të punonjësit që ka zëvendësuar E.M.

B. Me shkresën nr. 1060, datë 26.07.2018 të Komisionerit i është kërkuar Spitalit Rajonal Gjirokastrë kopje të dokumentacionit si më poshtë:

- Kopje të Rregullores së Brendshme të funksionimit të institucionit.
- Kopje të përshkrimit të punës dhe të kualifikimeve për punonjësit shoferë të Sektorit Teknik.
- Kopje të Urdhrit nr. 501, datë 26.12.2017 “Për verifikimin e dosjeve të personelit jo-mjekësor të administratës së Spitalit Rajonal Gjirokastrë për përputhshmërinë e vendit të punës me arsimin përkatës”.
- Kopje të raportit përfundimtar në zbatim të Urdhrit nr. 501, datë 26.12.2017 dhe masat e marra sipas gjetjeve të raportit.
- Kopje të përgjigjes së dhënë nga punonjësi E.M pas marrjes dijeni të shkresës nr.29, datë 08.01.2018 “Njoftim për plotësim të dosjes personale”.

- Emrat e punonjësve të tjerë të cilët kishin mangësi në dosje dhe për të cilët është marrë masë disiplinore.
- Kopje të vlerësimit të punës për vitet 2015, 2016 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2017 për E.M.
- Kopje të procedurës së verifikimit së mungesës së karburantit nga Zyra e Planit për punonjës të E.M.
- Kopje të verifikimit të konsumit të karburantit në Sektorin Teknik për të gjithë shoferët gjatë periudhës së vitit 2016 dhe 6-mujorit të parë të vitit 2017.

Spitali Rajonal Gjirokastrë ka marrë dijeni për shkresën, të vërtetuar me lajmërim marrje poste RR244877548AA, por nuk ka sjellë përgjigje.

C. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së E.M, Komisioneri me shkresën nr. 822/3, datë 24.08.2018 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 30.08.2018 duke i kërkuar palëve të parashtronin dhe argumentonin në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre si dhe të sillnin kopje të dokumenteve të sipërshënuara.

Sipas njoftimit të realizuar, palët kanë marrë dijeni për njoftimin, të vërtetuar me lajmërim marrje poste RR371060080AA dhe RR371060062AA por nuk janë paraqitur dhe nuk kanë njoftuar për prezencën e tyre.

Nga këqyrja e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, rezulton se me shkresën nr.85, datë 12.03.2015, E.M ka filluar punë pranë Spitalit Rajonal Gjirokastrë, në pozicionin si shofer ndërsa me shkresën nr.85/2, datë 15.06.2015 është emëruar në pozicionin si shofer ambulance dhe mes tij dhe Spitalit Rajonal Gjirokastrë është nënshkruar kontrata individuale e punës me afat të papërcaktuar.

Me shkresën nr.29, datë 08.01.2018 të Drejtorisë së Spitalit Rajonal Gjirokastrë, subjekti ankues është njoftuar që bazuar në Urdhrin nr.501, datë 26.12.2017 “Për verifikimin e dosjeve të personelit jomjekësor të administratës së Spitalit Rajonal Gjirokastrë për përputhshmërinë e vendit të punës me arsimin përkatës” të plotësojë dosjen personale të punës deri në datë 11.01.2018.

Me shkresën nr.111, datë 02.02.2018, të Drejtorisë së Spitalit Rajonal Gjirokastrë është urdhëruar lirimi i menjëhershëm i E.M nga pozicioni shofer në Sektorin Teknik, bazuar në Urdhrin nr.501, datë 26.12.2017 “Për verifikimin e dosjeve të personelit jomjekësor të administratës së Spitalit Rajonal Gjirokastrë për përputhshmërinë e vendit të punës me arsimin përkatës”, “Njoftimin për plotësim të dosjes personale” Nr. 29, datë 08.01.2018, si dhe ndodhur në situatën e daljes mangut në karburant, pas llogaritjeve mujore nga Zyra e Planit.

Referuar shkresës nr.405/1, datë 20.04.2018⁴ të Spitalit Rajonal Gjirokastrë drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vlerësohet se E.M është larguar nga puna për mosplotësimin në kohë të dosjes personale me dokumentet e kërkuara me shkresën nr.29, datë 08.01.2018 dhe mungesës së karburantit.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri vlerëson se, Spitali Rajonal Gjirokastrë ka dërguar shkresën nr.783/1, datë 28.06.2018 e cila, në pamje të parë duket sikur e përmbush detyrimin për të dhënë informacion në lidhje me ankesën, por në thelb nuk i shërben hetimit administrativ të filluar nga Komisioneri me qëllim marrjen e një vendimi për konstatimin ose jo të diskriminimit. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë i qartë dhe i drejtpërdrejtë në kërkesat e tij, në mënyrë që të mund të realizonte një hetim të paanshëm, objektiv dhe të arsyetuar lidhur me verifikimin dhe provimin e pretendimit të ankuesit.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që

⁴ Në shkresë në mes të tjerash sqarohet si më poshtë: *“...ish-punonjësi nuk i dorëzoi dokumentat e kërkuara në afatin e përcaktuar në njoftim dhe as më vonë, pranë zyrës së Burimeve Njerëzore. Detyrimi i bindjes ndaj Urdhrit të titullarit nuk u përmbush. Gjithashtu gjatë një kontrolli të bërë nga Zv/Drejtori Ekonomik dhe Përgjegjësi i Sektorit të Planifikim Prokurimeve, është konstatuar se punonjësi rezultonte në mungesa në karburant”*.

të jepte shpjegime dhe informacion mbi trajtimin e barabartë të punonjësve dhe të faktonte shkakun e prishjes së marrëdhënieve të punës me punonjësën E.M në mënyrë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kishte një bazë krahasimore dhe të shqyrtonte këtë ankesë në mënyrë sa më objektive dhe të paanshme. Komisioneri konstaton se Spitali Rajonal Gjirokastrë me dijeninë e plotë nuk ka ofruar bashkëpunim dhe nuk ka dhënë informacionin dhe shpjegimet e kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në pamundësi të një informacioni të detajuar mbi raportin përfundimtar të verifikimit të dosjeve të personelit për përputhshmërinë e vendit të punës me arsimin përkatës dhe të raportit të verifikimit të konsumit të karburantit në Sektorin Teknik për të gjithë shoferët gjatë periudhës së vitit 2016 dhe 6-mujorit të parë të vitit 2017, është vënë në situatën e pamundësisë për të arritur në konkluzionin mbi trajtimin e njëanshëm, të pafavorshëm apo jo të ankuesit krahasuar me punonjësit e tjerë, të ndodhur në kushte të njëjta apo të ngjashme.

Mungesa e dhënies së informacionit, ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatet e shqyrtimit të çështjes dhe marrjen e një vendimi brenda afatit ligjor.

Për sa më sipër, rezulton e provuar se Spitali Rajonal Gjirokastrë, ka shkelur nenin neni 32, pika 2 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 32, pika 2 *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*, si dhe neni 33, pika 13, *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”*:

b) personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;

Në lidhje me interesimin e subjektit ankues, Komisioneri konstaton se ankuesi pas dorëzimit të ankesës nuk ka shfaqur asnjë interesim për të ndihmuar me informacion shtesë apo lidhur me mënyrën se si po procedohej me ankesën e tij, dhe nuk është vënë në kontakt asnjëherë me strukturat e Komisionerit. Nga ana e inspektorit të çështjes është tentuar disa herë në datat: 29, 30.08.2018, 16.10.2018 dhe 05.11.2018 që të kontaktohej ankuesi nëpërmjet telefonit në numrin 068....., por ankuesi nuk është përgjigjur. Gjithashtu, ankuesi ka marrë dijeni për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 30.08.2018, të vërtetuar me lajmërim marrje poste RR371060080AA por nuk është paraqitur dhe nuk ka njoftuar për prezencën e tij.

Për sa më sipër, u konstatua se, në nenin 94/4, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, parashikohet: *“4. Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin⁵ 91 të këtij Kodi”*.

Në përfundim, rezulton se gjatë shqyrtimit të ankesës nr. 81, datë 07.06.2018, E.M ka qenë inaktiv për më shumë se 5 muaj. Ai është njoftuar për të marrë pjesë në zhvillimin e seancës dëgjimore, për

⁵ Neni 91, pika 1 e Ligjit 44/2015, parashikon se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm.”*

të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tij për diskriminim, por nuk ka kontaktuar dhe nuk është paraqitur asnjëherë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 94/4, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” dhe nenet 1, 3, 12/1, 21/1, neni 32/1, gërma a), nenin 33/10 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Spitali Rajonal Gjirokastrë, të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për mosdhënie të informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr.81, datë 07.06.2018 të E.M, për shkak se ankuesi ka braktisur çështjen.
3. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda një muaji nga marrja dijani, mbi masën administrative. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA